



REGIONAL  
ANTI-CORRUPTION  
INITIATIVE

With funding from

 Austrian  
Development  
Cooperation

# **Udhëzuesi i CPL me listat e kontrollit mbi Sektorin e Ndërmarrjeve Publike**

Botuesi: Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit  
Fra Andjela Zvizdovica 1, B/14, 71 000 Sarajevo, Bosnjë-Hercegovinë  
Tel: +387 33 296 321, Faks: +387 33 296 329, Email: [info@rai-see.org](mailto:info@rai-see.org)  
Faqja e internetit: [www.rai-see.org](http://www.rai-see.org)

Autorët: Prospector Ltd  
Jovan Nicić  
Nemanja Nenadić  
Ana Arsenijević Momčilović  
Igor Čorluka

Për botuesin: Desislava Gotskova - Drejtoresha e Sekretariatit të RAI-t  
Redaktor: Aneta Arnaudovska - Këshilltar i Lartë për Antikorrupsion  
Përkthimi: We translate Albania

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument u takojnë autorëve dhe nuk e pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtarë të Iniciativës Rajonale Kundër Korrupsionit, ose të shteteve të saj anëtare, dhe të Agjencisë Austriake për Zhvillim

**Maj, 2022**

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>4</b>
<b>2</b>	<b>Udhëzuesi i CPL në Sektorin e Ndërmarrjeve Publike .....</b>	<b>6</b>
	<b>2.1.</b> Qëllimi i Udhëzuesit – pse është e rëndësishme të vlerësohen rreziqet e korrupsionit në rregulloret në Sektorin e Ndërmarrjeve Publike dhe si mund t'i reduktojë përdorimi i listave të kontrollit këto rreziqe?.....	<b>6</b>
	<b>2.2.</b> Përcaktimi i korrupsionit, faktorëve rregullator të rrezikut të korrupsionit dhe vlerësimit të hapësirave për korrupsion në legjislacion.....	<b>7</b>
	<b>2.3.</b> Standardet dhe praktikat ndërkombëtare .....	<b>9</b>
	<b>2.4.</b> Korrupsioni i Procesit Legjislativ/Vendimmarrës .....	<b>11</b>
	<b>2.5.</b> Kuadri ligjor për Sektorin e Ndërmarrjeve Publike në juridiksionet e synuara – Konstatime të përgjithshme .....	<b>12</b>
	<b>2.6.</b> Si të zbatoni listat e kontrollit në nivel juridiksionesh kombëtare? Perspektiva e autoriteteve kombëtare dhe OSHC .....	<b>14</b>
<b>3</b>	<b>Listat e kontrollit .....</b>	<b>15</b>

# Udhëzuesi i CPL me listat e kontrollit mbi Sektorin e Ndërmarrjeve Publike

## 1. Hyrje

Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI) në partneritet me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) zbaton një projekt trevjeçar të quajtur Evropa Juglindore - Së bashku kundër Korrupsionit (SEE-TAC).<sup>1</sup> Veprimtaritë e Projektit, ndër të tjera, përfshijnë zhvillimin e udhëzuesve me në fokus sektorin e Vlerësimit të Hapësirave për Korrupsion në Legjislacion (CPL) me lista kontrolli dhe ushtrimet shoqëruese të trajnimit të personalizuar për ngritjen e thelluar të kapaciteteve në dy sektorë të përbashkët të prirur ndaj korrupsionit për të gjitha juridiksionet e synuara.<sup>2</sup>

Për nevojat e përgatitjes së veprimtarive të projektit drejt hartëzimit kombëtar dhe rajonal të sektorëve që duhet të jenë subjekt i ndërhyrjeve, Sekretariati i RAI dhe Ekipi i Ekspertëve të CPL kanë ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- **Sondazhi gjithëpërfshirës** - Metoda e parë e zbatuar ishte studimi dytësor i bazuar në rishikimin e dokumenteve më të rëndësishme kombëtare kundër korrupsionit (strategjitë, planet e veprimit, politikat, studimet e organizatave përkatëse ndërkombëtare të pranishme në vend dhe OSHC të përfshira në luftën kundër korrupsionit). Konteksti rajonal u studiua përmes rishikimit të konstatimeve dhe rekomandimeve nga raportet përkatëse të mekanizmave të monitorimit kundër korrupsionit dhe integritetit (Komisioni Evropian, GRECO, Cikli i Rishikimit të UNCAC) dhe rezultatet nga sondazhet rajonale dhe ndërkombëtare të perceptimit të korrupsionit (Barometri Ballkanik, Indekset e Perceptimit të Korrupsionit të TI, Barometri Global i TI, etj). Metoda e dytë e zbatuar ishte pyetësori i cili përfshinte pyetje mbi zonat e prirura ndaj korrupsionit në juridiksionet e synuara për të përcaktuar këndvështrimin e përfituesve dhe komentet e nevojshme për hartëzimin e sektorëve me interes të përbashkët të prirur ndaj korrupsionit.
- **Përcaktimi i kriterëve kryesore për hartëzimin e sektorëve të përbashkët** nga këndvështrimi i veprimtarive të mëtejshme të projektit në fushën e Vlerësimit të Rrezikut të Korrupsionit (CRA) dhe CPL në juridiksionet e synuara.
- **Organizimi i takimeve dhe konsultimeve dypalëshe me përfaqësues të institucioneve publike përkatëse nga juridiksionet e synuara.** Qëllimi kryesor i këtyre takimeve ishte prezantimi i Projektit RAI dhe identifikimi i sektorëve që duhet të jenë objekt i ndërhyrjeve në fushën e CRA dhe CPL në juridiksionet përkatëse.

Pas këtyre hapave, në një takim rajonal të mbajtur në korrik 2021, përfaqësuesit e të gjitha juridiksioneve të synuara dhe juridiksioneve të tjera të synuara nga projekti SEE-TAC ranë

<sup>1</sup> Më shumë detaje janë të disponueshme në <https://rai-see.org/what-we-do/see-tac/>

<sup>2</sup> Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kosova\* (\* Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e GJND për shpalljen e pavarësisë së Kosovës), Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. Këto juridiksione janë synuar në bazë të fazës së mëparshme të projektit dhe kanë shprehur interesin e përfituesve dhe përfaqësuesve të vendeve anëtare të Grupit Drejtues të RAI.

**dakord që sektori i Ndërmarrjeve Publike është një nga sektorët me interes të përbashkët të prirur ndaj korrupsionit dhe se ky sektor do të jetë subjekt i udhëzuesit specifik të CPL me lista kontrolli.<sup>3</sup>**

### **Metodologjitë e kërkimit dhe struktura e Udhëzuesit**

Metoda kryesore e kërkimit për këtë veprimtari ishte analiza dytësore e kuadrit legjislativ, institucionale për Sektorin e Ndërmarrjeve Publike në pesë juridiksione të synuara, duke përfshirë të dhënat e disponueshme mbi parimin e barazisë gjinore (p.sh. të gjitha ligjet e disponueshme në fushën e Ndërmarrjeve Publike, raportet dhe sondazhet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare mbi rreziqet e korrupsionit në rregulloret e Ndërmarrjeve Publike në juridiksionet e synuara, dhe dokumentet dhe politikat kryesore kundër korrupsionit për Sektorin e Ndërmarrjeve Publike të juridiksioneve të synuara). Gjithashtu, për të marrë informacion shtesë përkatës në lidhje me faktorët rregullator të rrezikut të korrupsionit dhe zbatimin e CPL në juridiksionin e synuar, pyetësi u përgatit për institucionet dhe organet përkatëse kombëtare, institucionet kompetente të Sektorit të Ndërmarrjeve Publike dhe OSHC përkatëse. Pyetësorit iu përgjigjën gjashtë përfaqësues të aktorëve nga juridiksionet e synuara. Përgjigjet dhe qëndrimet e tyre përfaqësuan një bazë të vlefshme për zhvillimin e këtij dokumenti të cilat u përfshinë në tekst.

Objektivi kryesor i Udhëzuesit është të ndihmojë juridiksionet kombëtare në identifikimin dhe reduktimin e faktorëve rregullator të rrezikut të korrupsionit në sektorin e Ndërmarrjeve Publike.

Dokumenti përmban dy komponentë kryesorë: a) Udhëzues për CPL në Sektorin e Ndërmarrjeve Publike, dhe b) Listat e kontrollit për faktorët rregullator të rrezikut të korrupsionit në legjislacionin e Sektorit të Ndërmarrjeve Publike. Në seksionin e parë, dokumenti trajton qëllimin e Udhëzuesit; përkufizon termat më të rëndësishëm; standardet ndërkombëtare dhe praktikën në fushën e CPL për Sektorin e Ndërmarrjeve Publike; korrupsioni i Procesit Legjislativ/Vendimmarrës dhe i kuadrit ligjor të këtij sektori në juridiksionet e synuara. Seksioni i dytë paraqet një pasqyrë të detajuar të faktorëve të identifikuar të rrezikut të korrupsionit rregullator në legjislacionin e Sektorit të Ndërmarrjeve Publike të juridiksioneve të synuara, të ndarë në pesë kategori.

---

<sup>3</sup> <https://rai-see.org/rai-secretariat-organized-regional-meeting-on-mapping-sectors-prone-to-corruption/>

## 2. Udhëzuesi i CPL në Sektorin e Ndërmarrjeve Publike

**2.1. Qëllimi i Udhëzuesit – pse është e rëndësishme të vlerësohen rreziqet e korrupsionit në rregulloret në Sektorin e Ndërmarrjeve Publike dhe si mund t'i reduktojë përdorimi i listave të kontrollit këto rreziqe?**

**Ndër faktorët e tjerë, zbatimi i legjislacionit të paplotë mund të rrisë probabilitetin për rastet e korrupsionit në praktikë.** Me krijimin e funksioneve publike, përcaktimin e kompetencave, detyrave dhe përgjegjësive zyrtare, rregulloret mund të krijojnë mundësi për interpretimin e kuptimit të synuar dhe gjenerimin e mundësive për korrupsion në të ardhmen.<sup>4</sup> Duke pasur parasysh këtë, vlerësimi i faktorëve të rrezikut të korrupsionit rregullator është një mjet i rëndësishëm që synon mbylljen e pikave hyrëse për parregullsitë e mundshme në praktikë bazuar në legjislacion. Vlerësimi i faktorëve të rrezikut të korrupsionit rregullator është veçanërisht i rëndësishëm për legjislacionin e sektorëve të prirur ndaj korrupsionit.

Për këtë dokument, “**ndërmarrjet publike**” përfshijnë lloje të ndryshme subjektsh biznesi (organizata), që përmbushin në mënyrë kumulative tre kriteret: 1) duhet të jenë në pronësi të plotë ose të pjesshme të shtetit (ose autoriteteve të ndryshme të nivelit nën-shtetëror), drejtpërdrejt ose tërthorazi (p.sh. në pronësi të një shoqërie tjetër shtetërore); 2) duhet të kontrollohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga shteti ose autoriteti publik specifik (p.sh. emërimi i menaxherëve, miratimi i planeve); 3) duhet të realizojnë ndonjë veprimtari me interes publik (ku përfshihen ndërmarrjet shtetërore që operojnë në treg dhe plotësisht mbi baza fitimi).

**Korrupsioni në ndërmarrjet publike paraqet një problem të përbashkët, veçanërisht për vendet në zhvillim.** Ndërmarrjet shtetërore (SOE) dhe ndërmarrjet publike si nëngrupi i tyre kanë një rol të rëndësishëm në ekonominë globale dhe ofrojnë mallra dhe shërbime të rëndësishme në sektorë të tillë si energjia elektrike, transporti dhe telekomunikacioni. SOE përbëjnë afërsisht dhjetë për qind të GDP botërore (Peng and others, 2016); më shumë se 50 për qind të produktit kombëtar bruto të ekonomive në zhvillim (Armstrong, 2015); dhe për rreth një të pestën e kapitalizimit të tregut botëror (Milhaupt and Pargendler, 2017)<sup>5</sup>. Në vitin 2014, OECD raportoi se 81 për qind (sipas vlerës) e rasteve të ryshfetit të huaj të hetuara ndërmjet viteve 1999 dhe 2013 ishin premtuar, ofruar ose dhënë zyrtarëve të SOE (OECD, 2014). SOE me zyrtarë të rangut të lartë publik janë shpesh në skemat e korrupsionit. Historikisht, SOE kanë qenë shumë të ndërthurura në proceset politike, duke vepruar si kuti të zeza për financimin politik të qeverive në pushtet. SOE përballen me rreziqe të veçanta korrupsioni për shkak të afërsisë së tyre me qeverinë, mbizotërimit të tyre në sektorë të prirur ndaj korrupsionit dhe praktikave të dobëta të qeverisjes së korporatës.<sup>6</sup>

**Në rajonin e Evropës Juglindore, Ndërmarrjet Publike janë identifikuar nga të gjitha juridiksionet e synuara si një nga sektorët e prirur ndaj korrupsionit<sup>7</sup>.** Proceset e prirur ndaj

<sup>4</sup> [http://www.undp-aciac.org/publications/3-](http://www.undp-aciac.org/publications/3-4March2020RegionalWorkshop/Corruption%20proofing%20of%20legislation%20-%20SESSION%205%20OCT.pdf)

[4March2020RegionalWorkshop/Corruption%20proofing%20of%20legislation%20-%20SESSION%205%20OCT.pdf](http://www.undp-aciac.org/publications/3-4March2020RegionalWorkshop/Corruption%20proofing%20of%20legislation%20-%20SESSION%205%20OCT.pdf)

<sup>5</sup> <https://www.unodc.org/e4j/en/anti-corruption/module-4/key-issues/corruption-in-state-owned-enterprises.html>

<sup>6</sup> Ibid.

<sup>7</sup> <https://rai-see.org/rai-secretariat-organized-regional-meeting-on-mapping-sectors-prone-to-corruption/>

korrupsionit që mund të identifikohen ndryshojnë, në varësi të veçorive specifike të sistemit ligjor të çdo juridiksioni, por me shumë elementë të përbashkët.

**Miratimi i legjislacionit të ri apo ndryshimi i ligjeve ekzistuese nuk mund të parandalojë apo zgjidhë ekskluzivisht të gjitha problemet që lidhen me korrupsionin në ndërmarrjet publike.** Megjithatë, ky “pesimizëm normativ” nuk mund të justifikojë mungesën e përpjekjeve për të përmirësuar legjislacionin, si për të plotësuar mangësitë e identifikuar, ashtu edhe për të larguar faktorët e identifikuar të rrezikut të korrupsionit që rrjedhin nga normat ekzistuese.

**Në vazhdim të rëndësisë së vlerësimit të faktorëve të rrezikut ndaj korrupsionit në legjislacion dhe sigurimin e kuadrit të përshtatshëm ligjor për sektorët e prirur ndaj korrupsionit, ky dokument synon të përmbledhë faktorët e mundshëm të rrezikut të korrupsionit specifik në Ndërmarrjet Publike për ligjet përkatëse dhe të propozojë rekomandime për reduktimin/eliminimin e faktorëve të identifikuar të rrezikut të korrupsionit.** Me fjalë të tjera, ky dokument ofron një pasqyrë të faktorëve të mundshëm të rrezikut të korrupsionit në legjislacionin e Sektorit të Ndërmarrjeve Publike, të grupuara në kategori, me rekomandime për zbutjen e këtyre faktorëve të rrezikut. Udhëzimet u dedikohen të gjithë aktorëve që marrin pjesë në përgatitjen, miratimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës për Sektorin e Ndërmarrjeve Publike nga këndvështrime të ndryshme – ministritë kompetente, institucionet e specializuara kundër korrupsionit, asamblatë kombëtare, shoqatat e biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe ndërmarrjet publike. Listat e kontrollit mund të aplikohen për identifikimin e faktorëve të rrezikut të korrupsionit në ligjet ekzistuese që janë relevante për ndërmarrjet publike dhe propozimin ose zbatimin e masave për reduktimin/eliminimin e këtyre faktorëve. Gjithashtu, listat e kontrollit mund të përdoren për shmangien e faktorëve të rrezikut të korrupsionit gjatë përgatitjes së ligjeve të reja të rëndësishme për punën e ndërmarrjeve publike. Bazuar në problemet e identifikuar në juridiksionet e synuara, ky dokument mund të zbatohet edhe më gjerë – në juridiksione të tjera – për të zbuluar dhe zvogëluar rreziqet rregullatore të korrupsionit në legjislacionin e Sektorit të Ndërmarrjeve Publike.

## **2.2. Përcaktimi i korrupsionit, faktorëve rregullator të rrezikut të korrupsionit dhe vlerësimit të hapësirave për korrupsion në legjislacion**

Për qëllimet e këtij dokumenti, **korrupsioni** përdoret në një kuptim të gjerë dhe përfshin çdo abuzim të një pozicioni ose ndikimi zyrtar, biznesi ose shoqëror që synon përfitimin personal ose për përfitimin e një tjetri, të gjitha format siç synohen nga Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër korrupsionit: vepra penale (ryshfet), ushtrimi i ndikimit, shpërdorimi i funksionit, përvetësimi, shkelja e dispozitave në lidhje me konfliktin e interesit, favorizimi, kufizime pas punësimit dhe financimi jo i pavend i partive.<sup>8</sup>

**Korrupsioni në Sektorin e Ndërmarrjeve Publike** merr forma të ndryshme, duke filluar nga ryshfeti në kontraktime, ofrimi i shërbimeve dhe rekrutimi i stafit, nepotizmi dhe patronazhi në postet me mandat dhe më shumë se çdo gjë, prania e ndikimit të fortë politik në operacionet e ndërmarrjeve publike që ndërron arritjen e funksioneve bazë dhe përmbushjen e interesit publik. Korrupsioni në këtë sektor ekziston si në atë sistematik (p.sh. emërimet bazuar në preferencat e partive politike dhe jo në merita, mungesa e ndarjes së rregullt të

---

<sup>8</sup> T. Hoppe, „Anti-Corruption Assessment of Laws (‘Corruption Proofing’) Comparative Study and Methodology“, [https://rai-see.org/php\\_sets/uploads/2015/06/Comparative\\_Study-Methodology\\_on\\_Anti-corruption\\_Assessment\\_of\\_Laws.pdf](https://rai-see.org/php_sets/uploads/2015/06/Comparative_Study-Methodology_on_Anti-corruption_Assessment_of_Laws.pdf)

roleve ndërmjet shtetit si pronar dhe stafit drejtues të SOE dhe autonomisë së plotë operacionale të saj; mungesa e dallimit të qartë ndërmjet rolit të shtetit si pronar dhe roleve të tjera të tij - p.sh. rregullator, politikë-bërës dhe prokuror) dhe nivelet individuale (p.sh. ryshfet, përvetësim).

**Rreziqet e korrupsionit të identifikuar në punën e ndërmarrjeve shtetërore**, globalisht<sup>9</sup> janë në lidhje me monofolet apo trajtimet preferencial që ato kanë në treg, mangësitë në kuadrin ligjor dhe rregullator, marrëveshjet e dobëta të pronësisë, bordet dhe stafet drejtuese të politizuara, kontrollet e brendshme të dobëta, pajtueshmërinë dhe menaxhimi i rrezikut dhe praktikave të dobëta të transparencës dhe zbulimit.

**Vlerësimi i hapësirave për korrupsion në legjislacion** përfaqëson një rishikim të formës dhe përmbajtjes së akteve ligjore (të hartuara ose të miratuara) në Sektorin e Ndërmarrjeve Publike për të zbuluar dhe minimizuar faktorët të rrezikut të korrupsionit që këto akte mund të vijnë në ndihmë gjatë zbatimit të tyre. Gjithashtu, CPL mund të përmirësojë cilësinë e vetë hartimit të legjislacionit. Si i tillë, zbatimi i duhur i CPL redukton paqartësitë dhe boshllëqet që mund japin shkas për interpretim në mënyrë diskrete, arbitraritet në zbatimin e ligjeve dhe gjenerimin e mundësive për korrupsion në të ardhmen.

Vlerësimi i hapësirave për korrupsion nuk bazohet në proceset dhe praktikën reale në ndërmarrje por në vetë legjislacionin. Domethënë, zbatimi i vlerësimit të hapësirave për korrupsion çon vetëm në rekomandime se si të përmirësohen rregullat ligjore të një ligji specifik për Sektorin e Ndërmarrjeve Publike, ndërkohë që nuk ka aspekte jo-normative. Megjithatë, CPL duhet të marrë parasysh se me cilat sfida do të përballë një ligj në jetën reale dhe cilat pengesa mund të ekzistojnë për zbatimin e duhur të rregullave në punën e ndërmarrjeve publike dhe subjekteve të tjera kompetente brenda sektorit.

Së fundi, CPL zgjeron më tej debatin publik dhe redukton aftësinë e organeve legjislative për të gjetur zgjidhje të shpejta ligjore, veçanërisht në rastet e miratimit të ligjeve me procedura të përshpejtuara dhe të shkurtuara. Sipas raporteve të ecurisë së BE për WB, një nga problemet e zbuluara ishte praktika e procedurave të shkurtra dhe të përshpejtuara legjislative që ndalon transparencën dhe rolin pjesëmarrës të CSO dhe publikut të gjerë në zbulimin e hershëm të rreziqeve të korrupsionit në legjislacion.<sup>10</sup>

Institucionet publike kompetente për hartimin e ligjeve duhet të kontaktojnë me qytetarët në fillim. Rekomandimet në lidhje me faktorët rregullator të rrezikut të korrupsionit të ofruara nga institucionet kundër korrupsionit dhe/ose organizatat e shoqërisë civile duhet të merren parasysh nga institucionet publike kompetente për hartimin e ligjeve për Sektorin e Ndërmarrjeve Publike. Këto institucione duhet të paraqesin komente të plota me shpjegim për institucionet kundër korrupsionit ose organizatat e shoqërisë civile në përputhje/mospërputhje me rekomandimet. Ato që u përmendën mund të konsiderohen si parakusht për një proces ligjor/vendimmarrës transparent dhe të përgjegjshëm.<sup>11</sup> Rritja e kontrollit rezulton paralelisht në pajisjen e agjencisë kompetente të vërtetimit dhe shoqërisë civile me një ekspertizë të bazuar diku që do të promovojë më tej cilësinë e hartimit ligjor.

---

<sup>9</sup><https://thedocs.worldbank.org/en/doc/600161611679881440-0090022021/original/StateOwnedEnterprises.pdf>

<sup>10</sup> Sfidat dhe pengesat për zgjerimin e Bashkimit Evropian në Rajonin e Ballkanit, Bruno Ferreira Costa (Universiteti i Beira Interior, Portugali), Janar, 2022

<sup>11</sup> [https://rai-see.org/php\\_sets/uploads/2015/06/Comparative\\_Study-Methodology\\_on\\_Anti-corruption\\_Assessment\\_of\\_Laws.pdf](https://rai-see.org/php_sets/uploads/2015/06/Comparative_Study-Methodology_on_Anti-corruption_Assessment_of_Laws.pdf)



**Faktorët rregullator të rrezikut të korrupsionit** janë veçori ekzistuese ose që mungojnë në një projektligj ose ligj të miratuar që mund të kontribuojnë në korrupsion, pavarësisht nëse kanë qenë të synuara apo jo<sup>12</sup> Në listat e kontrollit shoqëruese, të gjithë faktorët konkretë të identifikuar të rrezikut rregullator të korrupsionit në Legjislacionin për Sektorin e Ndërmarrjeve Publike renditen dhe përshkruhen në pesë kategoritë e mëposhtme:

1. Faktorët e rrezikut të korrupsionit në lidhje me paqartësitë;
2. Faktorët e rrezikut të korrupsionit që lidhen me transparencën dhe aksesin në informacion me rëndësi publike;
3. Faktorët e rrezikut të korrupsionit që lidhen me kompetencat, procedurat, të drejtat, detyrat dhe interesat;
4. Faktorët e rrezikut të korrupsionit që lidhen me mekanizmat e mbikëqyrjes;
5. Faktorët e rrezikut të korrupsionit që lidhen me përgjegjësinë dhe sanksionet.

### **2.3. Standardet dhe praktikat ndërkombëtare**

Asnjë nga konventat ose standardet ndërkombëtare ekzistuese nuk adreson drejtpërdrejt CPL. Neni 5, parag. 3 i Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit u bën thirrje Shteteve Anëtare që të vlerësojnë periodikisht instrumentet përkatëse ligjore dhe masat administrative në përcaktimin përshtatshmërisë së tyre për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Megjithatë, kjo dispozitë i referohet vetëm ligjeve specifike (“përkatëse”) kundër korrupsionit që “parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin”, por jo një vlerësimi të të gjitha rregulloreve për faktorët e rrezikut të korrupsionit.<sup>13</sup>

CPL është një disiplinë që filloi të vihej në zbatim relativisht në fillim të viteve 2000. Në fund të vitit 2019, CPL u bë pjesë e procesit ligjvënës në më shumë se 20 vende (Moldavia, Lituania, Koreja e Jugut, Letonia, Republika Çeke, Ukraina, Rusia, etj.). Në këto vende, institucionet kompetente kanë zhvilluar një metodologji për vlerësimin e faktorëve rregullator të korrupsionit. Në juridiksionet e Evropës Juglindore, një kontribut i rëndësishëm në zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të këtij mekanizmi antikorrupsion ka dhënë Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit - kryesisht në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut.

Në nëntor 2014, RAI, RCC, Ministria e Brendshme për Çështjet Vendore të Shqipërisë dhe Lidhësi Juglindor për Zhvillim dhe Integritet (SELDI) organizuan Konferencën Rajonale mbi Qeverisjen e Mirë dhe Sfidat e Politikave Kundër Korrupsionit.<sup>14</sup> Konferenca rekomandoi aplikimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Rrezikut Kundër Korrupsionit të Ligjeve.

---

<sup>12</sup> Për më tepër shihni, T. Hoppe, „Anti-Corruption Assessment of Laws (‘Corruption Proofing’) Comparative Study and Methodology”[https://rai-see.org/php\\_sets/uploads/2015/06/Comparative\\_Study-Methodology\\_on\\_Anti-corruption\\_Assessment\\_of\\_Laws.pdf](https://rai-see.org/php_sets/uploads/2015/06/Comparative_Study-Methodology_on_Anti-corruption_Assessment_of_Laws.pdf)

<sup>13</sup>“Udhëzuesi Legjislativ i UNODC për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”, 2012, faqe 24, Nr. 67, nuk thekson një udhëzim të ndryshëm nga formulimi i paragrafit 3, [https://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/LegislativeGuide/UNCAC\\_Legislative\\_Guide\\_E.pdf](https://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/LegislativeGuide/UNCAC_Legislative_Guide_E.pdf)

<sup>14</sup> <https://rai-see.org/regional-conference-on-good-governance-and-anti-corruption-policy-challenges-november-13-14-2014-tirana-albania/>

Gjithashtu, Konferenca miratoi **10 Parimet e Vlerësimit Efektiv të Hapësirave për Korrupsionin si një standard ndërkombëtar në këtë fushë.**<sup>15</sup>

Nëse ndjekim këto parime:

- Vlerësimi i hapësirave për korrupsion duhet të jetë i mundur për të gjitha projektligjet, ligjet e miratuara dhe të të gjithë sektorëve. Nëse është e nevojshme, përparësia duhet të bazohet në zbulimin e faktorëve të rrezikut në sektorët e prirur ndaj korrupsionit ose në fushat që kanë pasur raste korrupsioni.
- Kategoritë më të shqyrtuara të faktorëve rregullator të rrezikut të korrupsionit janë 1) paqartësia në gjuhë ose teknikë ligjore, dhe 2) boshllëqe në parandalim, në përcaktimin e afateve dhe procedurave, kompetencave të institucioneve publike, regjimit të sanksionimit, etj. Një shembull mund të jetë situata ku rregullat nuk parashikojnë afatin për pozitat e ushtruesve të detyrës ose dispozita të paqarta për kushtet e përzgjedhjes dhe renditjes së kandidatëve për pozita drejtuese apo të punësuar në ndërmarrjet publike.
- Vlerësimi i hapësirave për korrupsion duhet të zbatohet në të gjitha fazat e procesit legjislativ: gjatë hartimit në nivel ministror; miratimit të draftit nga qeveria; një shqyrtim vijues gjatë procesit parlamentar dhe pas miratimit dhe gjatë periudhës së vënies në zbatim.
- Të gjitha subjektet që hartojnë ligje duhet të jenë në përputhje me standardet ligjore të hartimit që shmangin faktorët rregullator të rrezikut të korrupsionit. Në mënyrë të ngjashme, komisionet parlamentare duhet të marrin pjesë në shqyrtimin e faktorëve rregullator të rrezikut të korrupsionit. Për më tepër, një organ kundër korrupsionit për parandalimin e korrupsionit duhet të jetë përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit dhe ligjit të miratuar. Qytetarët duhet të lejohen t'i shqyrtojnë lirisht projektligjet ose ligjet e miratuara sipas gjykimit të tyre.
- Institucionet ligjvënëse janë të detyruara të marrin në konsideratë rekomandimet e organit kundër korrupsionit për parandalimin e korrupsionit. Institucionet ligjvënëse duhet gjithashtu të paraqesin komente se cilat rekomandimeve iu janë përmbajtur dhe arsytet e moszbatimit të rekomandimeve të tjera. Gjithashtu, shoqëria civile duhet të lejohet të paraqesë vlerësimet e saj me shkrim të dorëzuara në një formë të standardizuar. Në rastet kur shoqëria civile ka paraqitur vlerësimin kundër korrupsionit, përfaqësuesit e tyre duhet të dëgjohen personalisht në seancat dëgjimore publike. Në rastet me interes të veçantë publik, parlamentet duhet të organizojnë seanca publike dëgjimore ekspertësh përpara debatit të tij.
- Të dhënat dhe informacioni për CPL duhet të jenë të disponueshme online (metodologjia, përzgjedhja e ligjeve, raportet e vlerësimit (përfshirë ato të shoqërisë civile), komentet mbi përputhshmërisë, përmbledhjet vjetore të veprimtarive dhe statistikat.

---

<sup>15</sup> [https://rai-see.org/php\\_sets/uploads/2015/05/10\\_Principles\\_on\\_Effective\\_Corruption\\_Proofing.pdf](https://rai-see.org/php_sets/uploads/2015/05/10_Principles_on_Effective_Corruption_Proofing.pdf)

- Mekanizmi i CPL kërkon një kuadër rregulator të qëndrueshëm dhe trajnim praktik ndërveprues për të gjitha organet shtetërore që përgatisin legjislacionin në të gjitha nivelet.

**Në disa vende që zbatohet CPL, organet kompetente kundër korrupsionit publikuan opinione/raporte mbi faktorët rregulator të rrezikut të korrupsionit në projektligjet përkatëse për Ndërmarrjet Publike<sup>16</sup>.** Këto dokumente përmbajnë konstatime dhe rekomandime se si të reduktohen/eliminohen faktorët e identifikuar të rrezikut rregulator të korrupsionit. Gjithashtu, analizat mbi kuadrin ligjor në këto vende janë burime të rëndësishme për zhvillimin dhe zbatimin e mjeteve të tjera kundër korrupsionit, si vlerësimi i rrezikut të korrupsionit (planet e integritetit) për këtë sektor.

**Ka disa studime në rang ndërkombëtar ose kombëtar** për korrupsionin në ndërmarrjet shtetërore të juridiksioneve të ndryshme. Këto studime nuk kanë fokus vetëm në faktorët rregulator të rrezikut të korrupsionit në legjislacionin përkatës. Megjithatë, ato përmbajnë disa konstatime mbi problemet e identifikuara në rregullore dhe rekomandime që mund të jenë të dobishme për reformat e mundshme legjislative edhe në rajonin e SEE.<sup>17</sup>

#### **2.4. Korrupsioni i Procesit Legjislativ/Vendimmarrës**

CPL synon vetëm rreziqet rregulatore të korrupsionit dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me korrupsionin e vetë procesit legjislativ, si ryshfeti i ligjvënësve ose praktikrat e dyshimta të lobimit. Megjithatë, zbatimi i këtij mjeti mund të ndihmojë në parandalimin e miratimit të “ligjeve të përshtatura/të korruptuara”, ku përshkruhen interesat e korruptuesve. Në përgjithësi, treguesit për një legjislacion të tillë të korruptuar mund të gjenden veçanërisht në fushat e përmendura më poshtë:

##### **I Veprimtaritë e jashtëligjshme**

- shkelja e rregullave të lobimit nga grupet e interesit;
- shkeljet e financimit politik nga kushdo që përfiton nga një ligj;
- shkeljet procedurale gjatë procesit legjislativ, veçanërisht për transparencën

##### **II Veprimtaritë ligjore**

- privilegjet e dyshimta në ligj për interesa të caktuara individuale ose interesa të grupit të individëve të ndërlidhur;
- donacionet e mëdha (por të ligjshme) financiare politike nga cilido që përfiton nga një ligj;
- veprimtari të jashtëzakonshme (të ligjshme) të lobimit nga ana e grupeve të interesit;

<sup>16</sup> Për shembull, opinioni i Agjencisë Serbe për Parandalimin e Korrupsionit (2016) për projektligjin për ndërmarrjet publike, i disponueshëm në <https://www.acas.rs/wp-content/uploads/2016/02/Misljenje-%D0%BE-Predlogu-zakona-o-javnim-preduzecima-final-.pdf>

<sup>17</sup> Për shembull, OECD (2018), “**State-Owned Enterprises and Corruption: What Are the Risks and What Can Be Done?**”, covering 37 OECD and non-OECD countries, i disponueshëm në: [https://www.oecd-ilibrary.org/governance/state-owned-enterprises-and-corruption\\_9789264303058-en](https://www.oecd-ilibrary.org/governance/state-owned-enterprises-and-corruption_9789264303058-en)

- mungesa e transparencës së procesit legjislativ (qoftë edhe formalisht brenda kufijve ligjorë), si p.sh. fshehja e disa aspekteve financiare të ndikimit të një projektligji;
- sfidat etike (pavarësisht përputhshmërisë me rregullat);
- disavantazhi i dukshëm ose shpërdorim i fondeve publike, të tilla si - dhënia e pronës publike për pronarët privatë nën vlerën e tregut ose - mbifinancimi i institucioneve publike për të cilat dihet se ekzistojnë fakte përvetësimi ose pasurimi të paligjshëm (siç deklarohet në raportet nga e gjykatës së audituesve).<sup>18</sup>

## 2.5. Kuadri ligjor për Sektorin e Ndërmarrjeve Publike në juridiksionet e synuara – Konstatime të përgjithshme

**Pothuajse të ë gjitha juridiksionet e synuara identifikuan ndërmarrjet publike si një nga fushat kryesore për interesin publik.** Meqenëse të gjitha juridiksionet e synuara deklaruan integritet në BE si një nga prioritetet, politikat dhe legjislacioni i tyre i përgjithshëm priren të jenë kryesisht në përputhje me politikat përkatëse të BE. Megjithatë, duke qenë se vetë BE nuk ka legjislacion të përbashkët kur bëhet fjalë për ndërmarrjet publike, në këtë fushë reformat e vendit mund të mos përfitojnë plotësisht nga mbikëqyrja e BE dhe procesi i negociatave për anëtarësim. Prandaj, ndikimi pozitiv i BE mund të jetë vetëm indirekt dhe në lidhje me sektorin më të gjerë publik dhe reformat kundër korrupsionit.

Puna dhe funksionimi i ndërmarrjeve publike rregullohet kryesisht përmes akteve të veçanta të legjislacionit ose përmes ligjit të përgjithshëm për shoqëritë tregtare dhe dispozitave që lidhen me shoqëritë shtetërore. Në Shqipëri, shoqëritë shtetërore i nënshtrohen **Ligjit Tregtar, pra ligjit 9901/2008**. Për më tepër, në raste të veçanta, fusha e gjerë rregullohet me ligje të ndryshme në sektorin e energjisë, energjisë elektrike, gazit natyror dhe energjisë termike, të harmonizuara me direktivat dhe rregulloret e BE.

Ligjet e veçanta për ndërmarrjet publike që ekzistojnë në Kosovë\* (**Ligji nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, Ligji nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike; dhe Ligji Nr. 05/L -009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111**)<sup>19</sup>, Republika e Moldavisë, (Ligji për Ndërmarrjet Shtetërore në Republikën e Moldavisë, LEGE Nr. 146, din 16.06.1994), Mali i Zi, (**Ligji për Ndërmarrjet Publike**, Gazeta Zyrtare nr. 6/91), Maqedonia e Veriut (**Ligji për Ndërmarrjet Publike**, Gazeta Zyrtare nr. 38/96, 9/97, 06/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 06/12),<sup>20</sup> dhe Serbia (**Ligji për Ndërmarrjet Publike**, Gazeta Zyrtare Nr.15/2016 dhe 88/2019). Përveç Ligjit për ndërmarrjet publike, Mali i Zi e rregullon punën e tij përmes Ligjit për subjektet e biznesit (Gazeta Zyrtare nr. 65/20) dhe disa ligjeve të veçanta që rregullojnë fushat e punës së ndërmarrjeve publike.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, nuk ka ndërmarrje publike që funksionojnë në nivelin e qeverisë qendrore. Prandaj, puna e ndërmarrjeve publike rregullohet me tre ligje, d.m.th. **Ligji për**

<sup>18</sup> Shih T. Hoppe, „Anti-Corruption Assessment of Laws (‘Corruption Proofing’) Comparative Study and Methodology“, [https://rai-see.org/php\\_sets/uploads/2015/06/Comparative\\_Study-Methodology\\_on\\_Anti-corruption\\_Assessment\\_of\\_Laws.pdf](https://rai-see.org/php_sets/uploads/2015/06/Comparative_Study-Methodology_on_Anti-corruption_Assessment_of_Laws.pdf)

<sup>19</sup> ‘Gazeta Zyrtare’, <https://gzk.rks-gov.net/>

<sup>20</sup> <https://www.lexadin.nl/wlg/legis/nofr/eur/arch/mac/LPE.pdf>

**Ndërmarrjet Publike në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës** (Gazeta Zyrtare e FBiH 8/05, 81/08, 22/09 dhe 109/12)<sup>21</sup> **Ligji i Republikës së Serbisë për Ndërmarrjet Publike** (Gazeta Zyrtare e Republikës Srpska 75/04), 78/11)<sup>22</sup> dhe **Ligjin për Ndërmarrjet Publike në rajonin Brčko të Bosnjës dhe Hercegovinës** (Gazeta Zyrtare e Rajoni Brčko BiH 22/2018 – teksti i konsoliduar dhe 5/2020)<sup>23</sup>.

Në të gjitha juridiksionet, ekzistojnë edhe legjislacione të tjera përkatëse për punën dhe parandalimin e korrupsionit në ndërmarrjet publike, që rregullojnë konfliktin e interesit të zyrtarëve publikë, aksesin e lirë në informacione me rëndësi publike dhe prokurimet publike.

**Të gjitha juridiksionet kanë disa dispozita në legjislacioni e tyre në lidhje me parimin e barazisë gjinore.** Megjithatë, dispozita të tilla nuk janë pjesë e legjislacionit bazë të ndërmarrjeve publike. Kryesisht, barazia gjinore rrjedh nga ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit (i çdo lloji) në punësimin në ndërmarrjet publike dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët e interesuar.

**Në juridiksionet e synuara, faktorët e identifikuar të rrezikut rregullator të korrupsionit lidhen kryesisht me paqartësinë dhe rregulloret të pamjaftueshme të disa çështjeve të rëndësishme.**

Kjo paqartësi njihet nga një numër i konsiderueshëm i të anketuarve, edhe kur bëhet fjalë për termat kryesor, por në veçanti kur bëhet fjalë për dispozitat ligjore **që mund të interpretohen në mënyra të ndryshme dhe me referencë të pamjaftueshme ndaj ligjeve të tjera.** Në anën tjetër, asnjë nga të anketuarit nuk ka identifikuar opinione apo udhëzime ligjore për zbatimin uniform të ligjeve për sektorin e ndërmarrjeve publike të miratuara nga Gjykata e Lartë apo ndonjë institucion tjetër përkatës.

**Mungesa e rregullores gjithëpërfshirëse** njihet pothuajse në të gjitha juridiksionet kur bëhet fjalë për **rregullat që synojnë parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit të menaxhimit të ndërmarrjeve publike dhe ndalimin e financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore, si dhe për shfrytëzimin e burimeve të ndërmarrjeve publike për promovimi politik.** Gjithashtu, në shumicën e juridiksioneve, mungesa e rregullores gjithëpërfshirëse njihet kur bëhet fjalë për **rregullat që synojnë parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit të punonjësve në ndërmarrjet publike.**

Fushat e tjera ku ekzistojnë boshllëqe ligjore që lidhen me çështjet, si p.sh. kush mund të vendosë për krijimin, transformimin, shitjen ose ndërprerjen e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive të tjera shtetërore, bazuar në kritere të paracaktuara dhe të qarta; procedurën për metodën e hapur konkurruese për zgjedhjen e stafit drejtues dhe punonjësve të ndërmarrjeve publike; dhe përgjegjësia e stafit drejtues të ndërmarrjeve publike në rast të performancës dhe mbikëqyrjes së dobët.

---

<sup>21</sup> <https://advokat-prnjavorac.com/legislation/Law-on-public-enterprises-in-the-Federation-of-Bosnia-and-Herzegovina.pdf>

<sup>22</sup> <https://advokat-prnjavorac.com/legislation/Law-on-public-enterprises-of-Republika-Srpska.pdf>

<sup>23</sup> <https://advokat-prnjavorac.com/legislation/Law-on-public-enterprises-of-Brcko-District-of-Bosnia-and-Herzegovina.pdf>

Të anketuarit nuk janë plotësisht të informuar për përhapjen e problemeve të mundshme kur bëhet fjalë për aksesin në informacione që kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike.

Probleme të tjera të identifikuar nga të paktën gjysma e të anketuarve përfshijnë kompetencat e paqarta apo dikskrete vendimmarrëse të autoriteteve përkatëse.

**Në të gjitha juridiksionet e synuara, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve kundër korrupsionit dhe institucioneve kompetente për Sektorin e Ndërmarrjeve Publike në procesin CPL në pesë vitet e fundit vlerësohet nga aktorët si pjesërisht i mjaftueshëm.** Institucionet kompetente për këtë sektor kanë pranuar disa nga rekomandimet e dorëzuara nga institucionet kundër korrupsionit. Megjithatë, ata nuk kanë paraqitur komente të plota për përputhjen/mospërputhjen me rekomandimet drejtuar organeve kundër korrupsionit. Gjithashtu, bashkëpunimi i organizatave të shoqërisë civile/shoqatave profesionale me institucionet kundër korrupsionit dhe institucionet kompetente për Sektorin e Ndërmarrjeve Publike në përgatitjen e rregulloreve, përfshirë CPL, ishte pjesërisht i mjaftueshëm. Përkatësisht, institucionet kundër korrupsionit kanë përfshirë në raportet/opinionet e tyre disa nga rekomandimet që OSHC/shoqatat profesionale kanë paraqitur, por nuk kanë paraqitur rregullisht komente për këtë. Gjithashtu, institucionet kompetente kanë pranuar disa nga rekomandimet që kanë dorëzuar OSHC/shoqatat profesionale, por nuk kanë paraqitur komente të plota për këtë.

## **2.6. Si të zbatoni listat e kontrollit në nivel juridiksionesh kombëtare? Perspektiva e autoriteteve kombëtare dhe OSHC**

Listat e kontrollit në tekstin e mëposhtëm paraqesin një pasqyrë të faktorëve të mundshëm të rrezikut rregullator të korrupsionit në legjislacionin e Sektorit të Ndërmarrjeve Publike të juridiksioneve të synuara, bazuar në përgjigjet e përfaqësuesve të tyre dhe analizat e kryera në zyrë, me rekomandimet e masave për zbutjen e këtyre faktorëve të rrezikut.

Listat e kontrollit mund të përdoren nga të gjitha institucionet kompetente, organet rregullatore dhe audituese, por edhe në një masë të caktuar nga ndërmarrjet publike kombëtare dhe lokale. Listat e kontrollit janë kryesisht një rikujtesë gjatë hartimit të rregulloreve të reja ose ndryshimeve të rregulloreve ekzistuese. Për zbatimin e duhur të Udhëzuesit me lista e kontrollit nga të gjitha institucionet kompetente, është shumë e rëndësishme që vlerësimi i hapësirave për korrupsion të jetë pjesë e procesit të hartimit të ligjit në përgjithësi. Gjithashtu, listat e kontrollit mund të përdoren nga shoqatat kombëtare të biznesit dhe organizatat aktive të shoqërisë civile në fushën kundër korrupsionit në përgjithësi ose në fushën e punës së sektorëve të ndryshëm ku funksionojnë ndërmarrjet publike, të cilat duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin e korrupsionit. Kryesisht, shoqatat e biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile mund të: ndihmojnë në identifikimin e faktorëve rregullator të rrezikut të korrupsionit bazuar në njohuritë e tyre specifike në këtë fushë; monitorojnë dhe mbështesin procesin e CPL së realizuar nga autoritetet përkatëse; kryejnë vetë analizat e CPL dhe mbrojnë ndryshimet dhe përmirësimet legjislative.

Duke ndjekur standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira krahasuese, listat e kontrollit për faktorët rregullator të rrezikut të korrupsionit në Sektorin e Ndërmarrjeve Publike mund të zbatohen si një rikujtesë për të gjithë aktorët për të shmangur faktorët rregullator të rrezikut të korrupsionit në të gjitha fazat e procesit legjislativ: gjatë hartimit në nivel ministrish; miratimi i planit nga qeveria; një rishikim vijues gjatë procesit parlamentar dhe pas miratimit dhe për një periudhë zbatimi.

### 3. Listat e kontrollit

<b>3,1. LISTAT E KONTROLLIT PËR FAKTORËT RREGULLATOR TË RREZIKUT TË KORRUPSIONIT NË LIDHJE ME PAQARTËSITË</b>			
<b>FAKTORËVE RREGULLATOR TË RREZIKUT TË KORRUPSIONIT</b>	<b>PËRSHKRIMI</b>	<b>SHEMBULL/VËREJTJE</b>	<b>MASAT PËR REDUKTIMIN/ELIMINIM E FAKTORËVE RREGULLATOR TË RREZIKUT TË KORRUPSIONIT</b>
